

## **PËRKRAHJA E INOVACIONEVE TË BIZNESEVE ME NDIKIM TË LARTË**

Fuqizoni inovacionin tuaj digjital ose të gjelbër për ta shkallëzuar atë, për të rritur ndikimin dhe për të adresuar sfida shoqërore.

### **CILAT NDËRMARRJE DHE ZGJIDHJE INOVATIVE KUALIFIKOHEN?**

Të gjitha kompanitë komerciale ose kooperative (përfshihen bizneset individuale):

- të regjistruara në Kosovë para datës 1 nëntor 2022;
- me të paktën 5 të punësuar;
- me qarkullim vjetor ndër 50 milionë EUR;
- që nuk kanë përfituar më shumë se 500,000 EUR financim të jashtëm (grante, kapital, kredi, etj.) gjatë tre viteve të fundit;
- që zbatojnë një produkt/shërbim inovativ, tashmë të testuar në treg, me gjenerim të dëshmuar të të ardhurave nga zgjidhja inovative (për të paktën 1 vit) dhe me ndikim në sfida shoqërore;
- që propozojnë një projekt biznesi 1-2 vjeçar, të ndërtuar rreth inovacionit të tyre;
- të afta të bashkëfinancojnë të paktën 50% të kostove të projektit.

**Mësoni më shumë dhe aplikoni  
para datës 6 shkurt 2026**

[www.luxaidbusiness4impact.lu  
/en/opencall-kosovo-ldf2](http://www.luxaidbusiness4impact.lu/en/opencall-kosovo-ldf2)



### **ÇFARË OFROHET?**

Bashkëfinancim nga **100,000** deri në **350,000 EUR**, që përfaqëson maksimumi 50% të kostos totale të projektit.

### **CILAT JANË REZULTATET E PRITSHME?**

- Një zgjidhje e dëshmuar dhe me kosto efektive që ofron rezultate të matshme ekonomike, sociale dhe/ose mjedisore;
- Një model i qëndrueshëm i biznesit, i gatshëm për shkallëzim dhe zgjerim të ndikimit në komunitet;
- Mobilizim shtesë i kapitalit për të mundësuar shkallëzimin brenda dy viteve pas përfundimit të projektit.



## INOVACIONI DIGJITAL

- Kompani që ofrojnë inovacion digjital për të nxitur **rritjen ose eksportin**;
- Ofrues shërbimesh ICT të gatshëm për **eksport dhe kompani outsourcing**, që po shkallëzojnë inovacionet e tyre digjitale dhe po zgjerojnë partneritete ndërkombëtare;
- **Iniciativa “nga shkathësitë në punësim”** që lidhin aftësitë digjitale dhe të gjelbra me mundësi punësimi në industri në zhvillim;
- **Zgjidhje HealthTech dhe e-health** të fokusuar në **fushën kardiovaskulare**.

## CILËT SEKTORË?

LuxAid Demonstration Fund mbështet shkallëzimin e inovacioneve në fushat si më poshtë:

## INOVACIONI I GJELBËR

- **Efiçienca e energjisë dhe tranzicioni drejt energjisë së pastër** në operacionet e biznesit;
- **Ekonomia qarkore** dhe modele të valorizimit të mbetjeve;
- **Agrobiznes i qëndrueshëm** dhe përpunim bujqësor qarkor;
- **Zgjidhje për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike** për efiçencë të ujit dhe siguri të burimeve.

## CILAT JANË KRITERET E PËRZGJEDHJES?

- Inovacioni dhe zgjidhja më kosto efektive
- Objektivi i qëndrueshmërisë komerciale
- Kapaciteti për bashkëfinancim
- Kapaciteti i zbatimit
- Ndikimi shoqëror, potenciali i shkallëzimit dhe qëndrueshmëria afatgjatë

## CILI ËSHTË PROCESI I PËRZGJEDHJES?



## Shkallëzoni ndikimin tuaj përmes inovacionit

Një iniciativë e financuar nga Dukati i Madh i Luksemburgut dhe e zbatuar nga LuxDev, Agjencia e Bashkëpunimit për Zhvillim e Luksemburgut.